



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:126861

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01180436

P.nr.246/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, me procesmbajtësen Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.P nga fshati. ... Komuna e Kaçanikut, i akuzuar për shkak të veprës penale Vjedhje pylli 349 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/IL.nr. 1055-8/19 të datës 12.06.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor jo publik më datë 24.09.2020, në praninë e Prokurores së Shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar – Ilirjana Berisha me autorizim, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 12.10.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: F.P nga fshati. ... Komuna e Kaçanikut, lindur më datë ... nga i ati F...dhe e ëma F... e gjinisë A..., me numër personal ..., i martuar, prind i 2 fëmijëve, punon me pllaka, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar edhe më parë, mbrohet në liri

ËSHTË FAJTOR

Më datë 03.05.2019, në Rajonin Ekonomiko Pyjor Biçec Komuna e Kaçanikut, në vendin e quajtur “Në krye të arave”, me qëllim të vjedhjes me sharrë motorike ka prerë dru të llojit të ahut rreth 2.79 m³, të cilat nuk kanë qenë të damkosura, i ka transportuar me t..., I..., ... me ..., me ç’ rast Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari të Komunës së Kaçanikut i ka shkaktuar në vlerë prej 377.62€

Me këtë veprim ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 par 1 të KPRK-së,

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon:

DËNIM ME GJOBË

I. Dënim me gjobë në shumën prej 300€ (treqind) eurove, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 3 këste afat prej 3 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk do të mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur për çdo 20 euro 1 dite burgim.

Nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës më këste do të revokohet.

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t'ia paguaj dëmin në shumë prej 377.62€.

III. Detyrohet i pandehuri që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1055-8/19 të datës 12.06.2019 kundër të pandehurit F.P nga fshati. ... Komuna e Kaçanikut për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par 1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 24.09.2020.

Seanca nuk ishte publike për shkak të pandemisë Covid 19 dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK-Nr.85/2020, të datës 29 maj 2020

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale dhe kërkoj nga gjykata që të shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, dhe gjatë fjalës përfundimtare ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit ngase i njëjti është bërë konform nenit 248 të KPP-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'ia shqipton dënim sipas ligjit.

Përfaqësuesja e palës së dëmtuar ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurorit të shtetit dhe si palë e dëmtuar parashtrohet kërkesë pasurore juridike për dëmin e shkaktuar dhe atë siç është përcaktuar në aktakuzën e ngritur ndaj të pandehurit.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht; Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par 1 të KPRK-së, në mënyrë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70, 71, 72 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, është kryefamiljar dhe mbajtës i familjes 4 anëtarëshe.

Gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale.

Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë duke u bazuar në minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit si dhe duke u bazuar në mundësitë ekonomike të pagesës së gjobës nga ana e të pandehurit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, ka shprehur pendesë për veprën e kryer, gjykata konsideron se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të parapara në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar, është marrë në bazë të nenit 458 par 2 të KPPK-së dhe duke u bazuar në pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe vlerësimit të dëmit të vlerësuar nga pala e dëmtuar.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua i pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, në t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 20.00 € dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr.246/19 datë 12.10.2020

Procesmbajtësja
Suzane Rudi

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.